



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2450/3 Prot

Rrëshen, më 23. 06. 2026

V E N D I M

Nr. 48 datë 22. 06. 2026

P Ë R

“MIRATIMIN E HAPJES SË RRUGËS TË RE AUTOMOBILISTIKE, QË LIDH LAGJEN “KOLSH”, FSHATI FUSHË LUMTH ME RRUGËN EKZISTUESE TË ZONËS, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN, 4601”, BASHKIA MIRDITË

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, të ligjit 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore”, *i ndryshuar*, neni 3, pika 11, të ligjit nr. 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” *të ndryshuar*, neni 6, gërma “i”, të VKM nr. 408, datë 13. 05. 2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” *të ndryshuar* me VKM nr. 686, datë 22. 11. 2017, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, ligji nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” *i ndryshuar*, Urdhërit nr. 290, me nr. 2450/1 prot, datë 11.06.2026, i Kryetarit të Bashkisë, “Për ngritjen e Grupit të Punës për verifikimin në terren”, Relacioni nr. 2450/2 prot, datë 16.06.2026, Planvendosjen së bashku me projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë; (Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit), pas diskutimeve në mbledhjen e Këshillit Bashkiak;

V E N D O S I:

1. Miratimin e hapjes së rrugës të re automobilistike, që lidh lagjen “Kolsh”, fshati Fushë Lumth, me rrugën ekzistuese të zonës, njësia administrative Rrëshen, 4601, Bashkia Mirditë
 - Sipërfaqja që përshkon gjurma e rrugës është rreth 150 m², me gjatësi rreth L = 30 m dhe gjërësi mesatare 5.00 m, sipas planvendosjes së miratuar
2. Plani i vendosjes së gjurmës së rrugës në Sh. 1:1 000, & Relacioni nr. 2450/2, prot, datë 16.06.2026, *bashkëlidhur, pjesë përbërse këtij vendimi*
3. Punimet dhe mirëmbajtja e rrugës automobilistike, do të kryhen nga komuniteti i zonës dhe Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes Mirditë
4. Pas ndërtimit, rruga do të jetë në përdorim të të gjithë komunitetit dhe pronë e Bashkisë Mirditë dhe në inventarin e Agjencisë së Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes Mirditë

5. Për ndjekje e zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë Mirditë, (Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, APPM-Mirditë dhe Njësia Administrative Rrëshen)

Ky vendim hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar!

SEKRETAR
Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR
Aleksandër PICA KU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2450/ Prot
3

Rrëshen më, 16 . 06 . 2026

P/VENDIM

Nr. 61 , datë 16 . 06 . 2026

PËR

**“MIRATIMIN E HAPJES SË RRUGËS SË RE AUTOMOBILISTIKE QË LIDH LAGJEN
KOLSH FSHATI FUSHË-LUMTH NJ.ADM. RRËSHEN 4601, BASHKIA MIRDITË ME
RRUGËN EKZISTUESE TË ZONËS SË RINDËRTIMIT”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 3, pika 11, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (të ndryshuar), neni 6, gërma “i”, të VKM.nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, (të ndryshuar); Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë; Urdhërit nr. 290, Nr. 2450/1 Prot datë 11.06.2026, i Kryetarit të Bashkisë, “Për ngritjen e grupiut të punës për verifikim në terren”, projekt –vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë (Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit), në këshillin bashkiak, pas diskutimeve të anëtarëve të këshillit bashkiak.

V E N D O S I:

1. Miratimin e hapjes së rrugës së re automobilistike që lidh lagjen Kolsh, fshati Fushë-Lumth, Njësia Administrative Rrëshen 4601, Bashkia Mirditë me rrugën ekzistuese të zones së rindërtimit.
- Sipërfaqja që përshkon gjurma e rrugës është rreth 150 m², me gjatësi L= 30 mL dhe gjerësi 5.00 mL, sipas planvendosjes së miratuar.
2. Planvendosja për miratimin e hapjes së rrugës së re automobilistike Sh. 1:1000, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Punimet dhe mirëmbajtja e rrugës automobilistike, do të kryhen nga komuniteti i zonës dhe Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes Mirditë
4. Pas ndërtimit, rruga do të jetë në përdorim të të gjithë komunitetit dhe pronë e bashkisë Mirditë dhe në inventarin e Agjencisë së Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes Mirditë.
5. Për ndjekje dhe zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Bashkia Mirditë, (Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, APPM-Mirditë dhe njësia administrative Rrëshen).


Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (të ndryshuar)!

SEKRETARI
Gasper TOPOLLAJ

KRYETARI
Aleksandër PICA KU

Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit të Territorit: Ark. J. TUSHA

Sektori Juridik: P/Sek. L. Gjergji



KRYETARI
Albert MËLYSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2450/2 Prot

Rrëshen më, 16.06. 2026

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN PËR

“MIRATIMIN E HAPJES SË RRUGËS SË RE AUTOMOBILISTIKE, ME GJATËSI
RRETH 30ML (0.03KM), QË LIDH LAGJEN “KOLSH”, FSHATI FUSHË-LUMTH
NJ.ADM RRËSHEN 4601,BASHKIA MIRDITË ME RRUGËN EKZISTUESE TË ZONËS
SË RINDËRTIMIT”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 3, pika 11, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (të ndryshuar), neni 6, gërma “i”, të VKM.nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, (të ndryshuar),. Urdhërit nr. 290, Nr. 2450/1 Prot., datë 11.06.2026, të Kryetarit të Bashkisë, “Për ngritjen e grupit të punës,për verifikim në terren”, projekt –vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë (Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit), në këshillin bashkiak, pas diskutimeve të anëtarëve të këshillit bashkiak.

Të nderuar Këshilltarë,

Ky relacion paraqitet në mbështetje të projektvendimit për ndërtim/rikonstruksion rruge auto, me gjatësi rreth 30 ml (0.03km) dhe gjerësi 5 ml që lidh lagjen “Zonën e Re Zhvillimore” Njësia Strukturore: **MR_UB_A2_114/39** qyteti Rreshen, me rrugën e propozuar në Plan të Përgjithshëm Vendor(zgjatim i rrugës Kolsh) , njësia administrative Rrëshen, duke përmirësuar infrastrukturën dhe aksesin për komunitetin.

Kjo nevojë paraqitet nga komuniteti për aksesimin dhe të drejtën legjitime të Servitutit të Kalimit,pasi pronat e tyre nuk aksesohen me rrugë.

Përshkrimi i studimit teknik

Sipërfaqja e gjurmës së rrugës: rreth 150 m2, me gjatësi rreth 30 ml (0.03km) me gjerësi mesatare rreth 5m.

Zona është pjesë e Zones së Re Zhvillimore nën administrim/pronësi të Bashkisë Mirditë.

Përshkrimi i parcelës ndërtimore objekt studimi, ku kalon gjurma e rrugës auto për ndërtim, tregon kryesisht tokë pa bimësi ose bimësi e ulet,në terren skarpatë sipas gjendjes ekzistuese të zonës .

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

Ndërhyrjet e parashikuara nuk e ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, dhe treguesit kryesorë të sipërfaqes ndërtimore bashkiake.

Argumentimi i nevojës

Nevoja për hapjen e rrugës objekt të këtij projektvendimi lind si domosdoshmëri për sigurimin e aksesit dhe komunikimit të rregullt me pronat dhe pasuritë e ndodhura në zonën përkatëse, të cilat aktualisht kanë vështirësi ose mungesë të lidhjes funksionale me rrugën publike.

Në përputhje me parimet e parashikuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë mbi servitutin e kalimit, pronari i një pasurie që nuk ka dalje të mjaftueshme në rrugë publike ka të drejtë të kërkojë kalim mbi pasuritë fqinje kundrejt kushteve të përcaktuara me ligj. Ky parim synon të garantojë përdorimin normal dhe efektiv të pasurisë, si dhe të shmangë izolimin e saj.

Hapja e kësaj rruge shërben për realizimin e interesit publik, përmirësimin e infrastrukturës vendore, garantimin e lëvizjes së banorëve dhe mjeteve, si dhe krijimin e kushteve për zhvillimin ekonomik dhe social të zonës. Gjithashtu, ajo mundëson aksesin e shërbimeve publike dhe emergjente, duke rritur sigurinë dhe cilësinë e jetesës së komunitetit.

Konkluzion

Për sa më sipër, realizimi i këtij projekti përmbush kriterin e interesit publik dhe përbën një ndërhyrje të domosdoshme për përmirësimin e infrastrukturës, garantimin e sigurisë publike dhe forcimin e mekanizmave institucionale për administrimin dhe mbrojtjen e territorit.

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit:

Ing. Gjeodet A. Dedaj

Dr. Ark. J. Tusha

KRYETARI

Albert MËLYSHI



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al